

2 ABU
Shkurtimi
P.K. Proh. Y. dt 25/01/2019



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 13 Datë 10/01/2019

Per miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujore te lumit Tomorrices dege e lumit Devoll, per prodhim energjie, nga subjektit "ERA HYDRO" sh.p.k në Bashkia Gramsh Qarku Elbasan.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni" te ndryshuare me V.K.M Nr 718 te dates 12/10/2016, Vendimit te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore" per paisjen me autorizim (miratim ne parim) të subjektit "ERA HYDRO" sh.p.k, me propozim të A.B.U. Seman, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

VENDOSI:

Miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujore te lumit Tomorrices dege e lumit Devoll, per prodhim energjie, nga subjektit "ERA HYDRO" sh.p.k në Bashkia Gramsh Qarku Elbasan

HEC BLINETA

Vepra e marrjes Nr1

X=5172693 Y=4515669 Z=262 m

- Prurja mesatare 5.7 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 7.8 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 1.18 m³/sek.

Godina e centralit

X=51584988 Y=4521404.8 Z=210 m

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 1968 kW

Per perdorimin e ketij burimi uxor duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN

Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBU SEMAN

Baki BALA

